

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-067/13

**Prishtinë
18 Nëntor 2014**

Në çështjen juridike të:

**M. A.
Sërbi**

Paraqitësia e ankesës

Kundër

I. I.

Pala përgjegjëse në kërkesë/ ankesë

Kolegji i Apelit i AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët: Willem Brouwer , Kryetarë i kolegjit , Sylejman Nuredini dhe Esma Erterzi gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesat kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KKPK/D/A/149/2012 (lëndët janë të regjistruara në AKP me numrat: KPA18346 i datës 19 prill 2012, pas seancës gjyqësore kryesore, të mbajtur më 18 Nëntor 2014, mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Ankesa e M. A. refuzohet si e pabazuar e paraqitura kundër vendimit të KPCC /D/A /149/2012 (lënda e regjistruara në AKP me numrat KPA 18346 i datës 19 prill 2012,
2. Konfirmohet vendimi KPCC /D/A /149/2012 (lënda e regjistruara në AKP me numrin KPA 18346)i datës 19 prill 2012,

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Me 29 nëntor 2006 M. A. ,ka depozituar një kërkesë të regjistruara në AKP (KPA18346) në cilësinë e titullarit të pretenduar të së drejtës pronësore në Agjencinë Kosovare të Pronës, duke kërkuar të drejtën e ri posedimit të pronës . Ai pretendon se babai tije i ndjerë J. A. është i regjistruar si pronar i pronave paluajtshme të kërkuara.
2. Për ta mbështetur kërkesën e tij, ai ka paraqitur në AKP dokumentet si në vijim:
 - Letërnjoftimin të lëshuar me datë 29 dhjetor 2005, nga organi kompetent.
 - Fletën Poseduese nr.501 të lëshuar nga Shërbimi për Kadastër dhe Prona të Paluajtshme, te Komunës së Prishtinës (organi paralel), i datës 01 qershor 2006.Me këtë fletë poseduese konstatohet se ngastra e kërkuar kadastrale është në emër të paraqitësit të kërkesës për 1/3 e pjesës ideale.
 - Certifikata e drejtave të pronës së paluajtshme të lëshuar nga Zyra Kadastrale ,Prishtinë UL.71914059-00501 i dt.31 mars 2008 është tërësisht dhe saktësisht identike me këtë fletë poseduese.
 - Kopjen e Planit të lëshuar nga organi kompetent i Komunës së Prishtinës të lëshuar më datë 02.07.1987.
 - Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë C.nr.345/80 i datës 10 mars 1981.
 - Aktvendimin e Gjykatës Komunale në Vërnjaçka Banjë të Tnr.155/01 i datës 28.09.2007, me të cilën konstatohet se trashëgimtar për 1/3 e ngastrës kadastrale nr.77/2 me kulturë kullosë në sipërfaqe prej 0.14.20 ha, sipas fletës poseduese 501 të Zyrës Kadastrale në Prishtinë, është shpallur djali i tij A. Q.

3. Ekipi verifikues i Agjencisë Kosovare të Pronave sipas raportit të notifikimit dhe konfirmimit ka bërë notifikimin e kësaj ngastre kadastrale me datë 23 shkurt 2012 dhe me 24 shkurt 2012 që janë objekt i kërkesës. Mbas këtij raporti të notifikimit është konstatuar se këtë ngastër kadastrale e shfrytëzon Y. B. i cili pretendon të drejtën e pronës mbi këtë pronë të paluajtshme.
4. Pala përgjegjëse në kërkesë duke marrë pjesë në procedurë pretendon se ngastra kadastrale që është objekt i kërkesës ai është pronar i së njëjtës duke e paraqitur një deklaratë të datës 27.11.2007, si dhe kontratën e shitjes të datës 23 prill 1970. Me këtë kontratë konstatohet se S. B. ngastrën kadastrale 77/2 ia ka shitur A. R.
5. Sipas Certifikatës të Entit Gjeodezik Republikan të Serbisë -Shërbimi për Kadastër të Pronës së Paluajtshme të Komunës së Prishtinës nr.952-01-04/97-2180 i datës 04 mars 1997 , konstatohet se ngastrat kadastrale 77/1 dhe 77/2 mbi bazën e matjeve detale nga viti 1967 janë të regjistruara në emër të S. B.
6. Sipas raportit të verifikimit të AKP-së i datës 16 shtator 2011 konstatohet se fleta poseduese nr.501 që referohet në ngastrat kadastrale 77/1 dhe 77/2 janë verifikuar pozitivisht.
7. Sipas certifikatës mbi të drejtat e pronës së paluajtshme UL-71914059-00501 i datës 12 shkurt 2008, ngastra kadastrale 77/2 ka qenë e regjistruar në emër të S. B. Ndërkaq, në bazë të aktgjykimit të Gjykatës Komonale në Prishtinë C.nr.345/80 i datës 10.03.1981, kjo pronë mbi bazën e aktvendimit të Departamentit të kadastrit 011.nr.952/107 i datës 23.11.2008, është regjistruar në emër të A. M. për 1/3 e pjesës ideale të kësaj prone të paluajtshme. Në bazë të dhënave të Agjencisë Kadastrale të Kosovës P-41914059-00077-2 i datës 02 maj 2010, prona e paluajtshme që është objekt i kërkesës është regjistruar në emër të paraqitësit të kërkesës për 1/3 e pjesës ideale.
8. Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës (KKPK) në lidhje me pronat e kërkuara, me vendimin e saj KKPK/D/A/149/12 datë 19. prill 2012, ka vendosur që kërkesa e M. A. të hedhet si e palejueshme. Kjo me arsyetim se babai i tij pronën e kërkuar ia ka dhënë S. B. për shfrytëzim ndërsa ai të njëjtën e ka shitur. Me aktgjykimin e Gjykatës Komonale në Prishtinë C.nr.345/80, M. A. i është pranuar e drejta e pronës për 1/3 të pjesës ideale. Paraqitësi i kërkesës është larguar nga Kosova në vitin 1992. Duke qenë se kërkesa pronësore e paraqitësit të kërkesës nuk e ka humbur posedimin si pasojë e konfliktit që ka ndodhur në Kosovë gjatë vitit 1998-1999, nga dhe për shkak të mungesës së juridiksionit ia

ka hedh të njëjtën. Meqenëse procedimi gjyqësor lidhur me pronën e kërkuar kanë filluar në vitin 1980 ndaj edhe sipas nenit 18 të Rregullores së UNMIK-ut nr.2006/50 e ndryshuar me ligjin nr.03/L-079 ia ka hedhur kërkesën për shkak të mungesës së juridiksionit.

Pretendimet ankimore:

9. Ankuesi M. A. ,me kërkesën e paraqitur pretendon se vendimi ankimor është përfshirë me zbatim të gabuar të gjendjes faktike, zbatim të gabuar të nenit 3 të Rregullores së UNMIK-ut nr.2006/50 dhe Ligjit të procedurës kontestimore andaj i propozon gjykatës që të njëjtin vendim ta ndryshojë dhe kërkesën e saj ta aprovojë.
10. M. A. vendimin ankimor e ka pranuar me 26 nëntor 2012, ndërkaq ankesë ka paraqitur me 21 dhjetor 2012. Y. I. vendimin ankimor e ka pranuar me 21 dhjetor 2012 dhe se ai nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Arsyetimi ligjor

Pranueshmëria e ankesave:

11. Gjykata Supreme pas shqyrtimit dhe vlerësimit të vendimit ankimor dhe ankesave të paraqitura sipas nenit 194 të LPK-së gjeti se:
Ankesa është e pranueshme, por e pabazuar.
Nuk është kontestuese se:
12. Në mes palëve ndërgjyqëse-paraqitësit të kërkesës dhe palës përgjegjëse në kërkesë-ankesë nuk është kontestuese se babai i paraqitësit të kërkesës ia ka dhënë në shfrytëzim S.B. ngastrën kadastrale 71/2.
13. Ngastra kadastrale që është objekt i kërkesës sipas Certifikatës të Shërbimit për Kadastër të Pronës së Paluajtshme nr.952-01-4/97-2180 i datës 04 mars 1997, është regjistruar në emër të S.B. nga viti 1967.Po kështu kjo ngastrë kadastrale sipas Certifikatës mbi të drejtat së pronës së paluajtshme UL-71914059-00501 i datës 02 dhjetor 2008, ka qenë e regjistruar në emër të S.B.

14. Sipas kontratës së shitjes së datës 23 prill 1970 S.B. ia ka shit pronën e paluajtshme 77/2 A.R. (dajës së palës përgjegjëse).
15. Sipas aktgjyqimit të Gjykatës Komonale në Prishtinë C.nr.345/80 i datës 10 mars 1981, paraqitësit të kërkesës i është pranuar e drejta e pronës për 1/3 e pjesës ideale të ngastrës kadastrale 77/2 dhe këto ndryshime janë evidentuar në bazë të dhënave bazë për njësi (unit Base data) të datës 02 maj 2010.
16. Paraqitësi i kërkesës konfirmon se shtëpitë në këtë ngastër kadastrale janë ndërtuar para konfliktit dhe ata janë larguar nga Kosova në viti 1992 përkatësisht në vitin 1995. Ndërkaq, pala përgjegjëse pretendon se në këtë ngastër kadastrale janë ndërtuar disa shtëpi kur dhe është blerë ajo pronë e paluajtshme.
17. Në bazë të provave të administruara dhe fakteve të vërtetuara Gjykata Supreme e Kosovës gjen se, vendimi ankimor lidhur me faktet e rastit dhe ligjin e zbatueshëm është i drejtë dhe i ligjshëm, kur kanë vendos që kërkesa e paraqitësit të kërkesës të hedhet poshtë për shkak të mungesës së juridiksionit. Kjo nga se humbja e posedimit nga paraqitësi i kërkesës për pronën e kërkuar nuk është rezultat i rrethanave që ndërlidhen drejtpërdrejtë apo që rezultojnë nga konflikti i armatosur në vitin 1998-1999.
18. Po kështu paraqitësi i kërkesës ka konfirmuar se pronën nuk e kanë pasur në posedim që nga viti 1992 kur ata janë shpërngulur nga Kosova.
19. Nga kjo mund të përfundohet siç pohon edhe ai vet se ata nuk janë ç vendosur nga prona e kërkuar ose nuk e kanë humbur posedimin apo kontrolli mbi pronën e tillë si pasojë e konfliktit.
20. Kjo për më tepër nga se sipas certifikatës për drejtat e pronës së paluajtshme e datës 02 dhjetor 2008 dhe certifikatës të datës 04 mars 1997, ajo pronë ka qenë e regjistruar në emër të S. B.
21. Rrjedhimisht mbi të mësipërmen Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se sikundër konstatimit faktik ashtu edhe konkludimi juridik i vendimit ankimor është i drejtë dhe i ligjshëm ndaj edhe sipas dispozitës së nenit 13 par.3 nën par (c) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr.03/L-079 u vendos si në dispozitiv të aktvendimit.

Këshillë ligjore:

22. Sipas 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet me mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

Willem Brouwer, Kryetarë i Kolegjit, EULEX

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Esmat Erterzi, Gjyqtare e EULEX-it

Urs Nufer, Referent i EULEX-